Vdekja e ish-drejtorit të Shëndetësisë në Deçan, Policia jep detajet

11:37 | 19 Mars 2021

Policia e Kosovës ka dhënë detaje rreth vdekjes së ish drejtorit të shëndetësisë në Komunën e Deçanit.

Policia njofton se ish drejtori Mustafë Hasanaj është gjetur i shtrirë në oborrin e tij dhe i njëjti kishte një plagë në gjoks, ku dyshohet se ishte shkaktuar nga arma e zjarrit, ndërsa rasti ka ndodhur të enjten rreth orës 07:50.

“Deçan, 18.03.2021 – 07:50. Raportohet se viktima mashkull kosovar është gjetur i shtrirë në oborrin e tij dhe i njëjti kishte një plagë në gjoks, ku dyshohet se ishte shkaktuar nga arma e zjarrit. Në afërsi të viktimës është gjetur një pistoletë, e cila dyshohet se është përdorur në rast. Viktima është dërguar për tretman mjekësor në Spitalin e Pejës, ku dhe ka ndërruar jetë. Me vendim të prokurorit, trupi i pa jetë është dërguar për obduksion në IML. Rasti duke u hetuar nga njësitë relavante policore”, thuhet në raport.

Shpërndaje në rrjete sociale

Lajmet më të lexuara

Të ngjashme

Vdekja e ish-drejtorit të Shëndetësisë në Deçan, Policia jep detajet

11:37 | 19 March 2021

Policia e Kosovës shqipton 1724 tiketa trafiku për 24 orë

11:33 |

Abdixhiku takon Ambasadorin norvegjez, flasin për formimin e institucioneve

11:29 |

Foto lajm

Rreth 200 autobusë bllokojnë rrugët e kryeqytetit

10:32 | 19 Mars 2021

© Arbresh.info 2015-2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.